

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të mbështetur në shkaqe të paarsyeshme dhe jo objektive nga ana e Komisionit Disiplinor të ISHPSHSH-së, i cili ka marrë Vendimin nr. 2556/1, datë 06.11.2018, në bazë të rekomandimeve të lëna në Raportin e Kontrollit “Për zbatimin e rekomandimeve të Task forcës ndërinstitucionale Antikorrupsion”.

Në këto kushte, në referencë të nenit 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se ankesa nr. 177, datë 15.11.2018, e Znj. S. M. është haptazi e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 4, nenin 7, pika 1, nenin 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) dhe pika 10 të këtij neni, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 177, datë 15.11.2018, e Znj. S. M., pasi kjo ankesë është haptazi e pabazuar.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

(Fusha- Punesim  
Shkak - “gjinia” dhe “bindja politike”)